



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 19.09.2022, e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Nora Kelmendi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitija (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Rita Zeqiri (LVV), Berat Lahu (LVV), Triera Kasumi-Berisha (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Granit Geci (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Endrit Gashi (AAK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

**Munguan:** Arianit Beqiri (LVV), Liridon Selmani, (PDK) dhe Taulant Maxharraj (AAK).

**Të pranishëm ishin edhe:** Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkryetar, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbër Sadiki, drejtor i Urbanizmit, Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Adelina Sahiti, drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Besianë Musmurati, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina**, kryesues, i cili tha se në përbërjen e GP të LDK-së është bërë një ndryshim, pasi që z. Fisnik Osmani për arsye personale,

ka dhënë dorëheqje nga pozita e këshilltarit komunal, kështu që atë e zëvendëson asamblisti i radhës, z. Hafiz Krasniqi, dhe kërkoi që anëtari i ri i Kuvendit të bëjë betimin para Kuvendit.

**Kryesuesi** konstatoi se në sallë janë të pranishëm 45 anëtarë të Kuvendit, kështu që vazhdoi mbledhjen duke e hapur diskutimin për rendin e ditës.

**Jeta Rafuna** tha se duke pasur parasysh kërkesën e Sindikatës së punëtorëve të Komunës së Prishtinës, ne si GP i LDK-së propozojmë që në rend të ditës të futet pika: "Propozimvendimi për financimin e shujtave ditore për shërbyesit civilë të Komunës së Prishtinës".

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e znj. Rafuna.

**Kryesuesi** konstatoi se më 42 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, u miratua propozimi, që Propozimvendimi për financimin e shujtave ditore për shërbyesit civilë të Komunës së Prishtinës të futet në rend të ditës për shqyrtim.

Më propozimin e dhënë, kryesuesi konstatoi se njëzëri më 45 vota për, u miratua ky

#### **Rend i ditës:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë dhe të gjashtë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Raporti i punës së Kryetarit për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2022;
3. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2023;
4. Propozimvendimi lidhur me Kornizën afatmesme buxhetore për periudhën 2023-2025;
5. Informatë për raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe plani i zbatueshmërisë për të gjeturat e këtij raporti;
6. Raportimi i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të: Flora (Hasan) Çunajt, Arta (Nysret) Maliqit, Fatima (Hamit-Vej Nusret) Maliqit, Hana (Nysret) Maliqit, Arbëresha (Adem) Maliqit, Nevzat (Adem) Maliqit, Nexhat (Adem) Maliqit, Nakije (Nysret) Morinës, Nazan (Adem) Maliqit, Selamete (Hasan) Maliqit, Mevlyde (Hasan) Maliqit, Zana (Hasan) Sejdiut, Albulena (Hasan) Maliqit, Maliq (Abdul) Maliqit, Mihibe (Hasan) Makollit, Gëzim (Hasan) Maliqit dhe Luan (Nysret) Maliqit;
8. Projektregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës, nr. 01-030/01-0134831/18, dt. 06.06.2018;

9. Propozimvendimi për transferimin e mjeteve nga kategoria e subvencioneve të administratës në kategorinë e subvencioneve të Drejtorisë së Arsimit;
10. Propozimvendimi për financimin e shujtave ditore për shërbyesit civilë të Komunës së Prishtinës.
11. Pyetje dhe përgjigje;
11. Të ndryshme.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë dhe të gjashtë të Kuvendit të Kryeqytetit.

Kryesuesi konstatoi se më 39 vota për dhe 1 abstenim, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë dhe të gjashtë të Kuvendit të Kryeqytetit.

#### Pika e dytë

Raporti i punës së Kryetarit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Përparim Rama, kryetar.

**Gëzim Sveçla** tha se edhe pse është dashur që këtu në këtë dokument të quajtur raport, të raportohet për punët që janë bërë, në fakt këtu më tepër flitet për punët që planifikohen të bëhen, flitet për mendimet që mendohet se do të ndodhin në një të ardhme në kushte të tilla. Ky material ngjan me një material propagandistik zgjedhor, sesa një raport zyrtar mbi punët e realizuara në kryeqytet. Përkundrazi, qysh në fillim të raportit menjëherë shpërfaqet tendenca tashmë e njohur nga të gjithë, e kryetarit Rama për përvetësimin e meritave dhe marrja e autorësisë për punët dhe veprimet e të tjerëve, dhe është e pakuptimtë se si tentohet që punët të kryera dhe të arritura të paraqiten si mbajtja e festivaleve të ndryshme, të cilat tashmë janë tradicionale për kryeqytetin. Festivalet "Sunny Hill", "Chopin Piano Fest", "Etno Fest" etj., pra këto festivale ishin këtu për vite të tëra. Po ashtu, nga 206 premtime për këtë periudhë janë realizuar 7 prej tyre dhe nga këto 7, 5 prej tyre janë premtime që kanë të bëjnë me procedura për konkurs e thirrje për aplikim dhe asnjë projekt i përfunduar i infrastrukturës. Nga kjo mund të konstatojmë se ky raport i kryetarit është një raport kozmetik pa përmbajtje, njësoj siç është kozmetike e gjithë puna e tij gati 10 muaj. Qytetarët nuk votuan për një kryetar që angazhim kryesor e ka pjesëmarrjen në gala mbrëmje e festa, kurse punët kryesore i anashkalon. Prandaj këto improvizime nuk shiten më tek qytetarët e Prishtinës, nuk kalon kjo qasje, tashmë maskat kanë filluar të bien dhe po shpërfaqen fytyrat, interesat dhe qëllimet e vërteta.

**Jeta Rafuna** tha se ky raport i kryetarit ka pasqyruar punët e shumta të përmbyllura që nga pranimi i mandatit, projektet e shumta të filluara e shumë të tjera që janë në proces dhe të planifikuara.

Kryetari dhe ekipi i tij kanë bërë punë të jashtëzakonshme në të gjitha drejtoritë dhe dikasteret, kanë ndërhyrë në të gjitha temat e rëndësishme vitale për jetën e qytetarëve të Prishtinës, si në zhvillimin e infrastrukturës, renovimin e rrokaqiejve, renovimi i disa shkollave, krijimi i Zyrës së arkitektit të qytetit, përmirësimin e kushteve në sektorin e shëndetësisë, subvencionimin e fermerëve të fushave të ndryshme, mbajtjen e disa manifestimeve, si atë "Manifesta", "Sunny Hill" e të tjera.

Po ashtu, një angazhim të veçantë kryetari e ka pasur edhe në përmirësimin e mjedisit, ku sot kemi rigjenerim dhe rikultivim të hapësirave të sipërfaqeve të gjelbëruara, hapjen e disa bashkësive të reja lokale, si dhe shumë punë të tjera që janë më se të nevojshme për jetën e qytetarëve të Prishtinës.

**Leutrim Retkoceri** tha se raportimi i punës së kësaj qeverisjeje për 6-mujorin, i prezantuar nga kryetari, është i një rëndësie të veçantë dhe uroj që ky raport të bëhet gjithmonë në këtë kohë. Në këta 6 muaj kishte rezultate konkrete, kishte synime shumë më të larta, por kjo është Prishtina me shumë probleme, për të cilën duhet të angazhohemi të gjithë, që t'i zgjedhim të gjithë së bashku, mos të presim vetëm nga një person, të tjerët të dalin të kenë vetëm fjalë dhe jo veprime.

Shërbime për qytetarët janë afruar këta 6 muaj më shumë sesa muajt e kaluar, këto shërbime ishin edhe në infrastrukturë, ishin edhe në lagje të qytetarëve, në të cilat lagje për vite të tëra nuk kishte prekur dora e Komunës. Për gjithë angazhimin që është bërë mund t'i bëjmë një falënderim kryetarit Rama, gjithashtu nënkryetarëve, Donjetës dhe Albanit, dhe të gjithë drejtorëve, të cilët kanë bërë përkushtimin e tyre në drejtim të zhvillimit të punëve të mira në kryeqytet.

**Bahri Gashi** tha se po t'i referohemi në detaj këtij raporti, shihet se fatkeqësisht ka korresponduar shumë keq në krahasim me raportin financiar. Aty thotë që veç 5.14 % të buxhetit të investimeve kapitale është shpenzuar, aty shihet një listë e gjatë, ku shumica e atyre projekteve kanë filluar më herët, nuk janë të kësaj administrate. Shumë probleme nuk janë të cekura, si ajo e qenve endacakë, problemi me mbeturina dhe as në buxhet nuk ishte menduar asgjë për këto probleme. Do të ishte mirë me u marrë me probleme pak më serioze, jo me ato administrative.

**Gëzim Mehmeti** tha se sa i përket çështjes së raportit, e shoh të thatë, të zbrazët, por shpresojmë se do të ketë ndryshime pozitive. Unë gëzohem për çdo projekt të cilin ju e realizoni dhe do ta keni gjithmonë përkrahjen tonë.

**Endrit Zabërgja** theksoi se derisa flasim fillimisht për këtë raport, vërehet se kritikata e kaluara kanë ndikuar për të hartuar një raport krejt ndryshe nga ai i 100-ditëshit, në të cilin kishin përshkruar vetëm detyrat e supozuara dhe jo të përfunduara. Në këtë periudhë kohore ka pasur punë të mira, të cilat nuk mund të mohohen, e që janë të renditura këtu, por krahas këtyre punëve ka shumë probleme, si çështja e mbeturinave, ndriçimi publik, infrastruktura etj. që mbesin pa tentativa konkrete. Prej 206 premtimeve që ka dhënë kryetari, janë realizuar vetëm 7 premtime, nëse kështu vazhdon i bie që deri në përfundim të mandatit nuk do të realizohen më shumë se 56 premtime, apo vetëm 27 % të programit të tij.

Lidhur me këtë ceku se nga gjithë kjo, në veçanti i përgëzoj drejtorët e Drejtorisë së Kulturës dhe Drejtorisë së Sportit, me të cilët kemi pasur takime dhe bashkëpunim në kuadër të komitetit, dhe konsideroj se situatat e menaxhuara në raport me aktivitetet kulturore këtë verë kanë qenë mjaft sfiduese, por edhe të suksesshme nga ana e drejtorisë. **Ermal Osmani** fillimisht u përqendrua në disa pika të raportit, siç janë ajo e lirimt të trotuareve nga shitësit ambulantë. Po ashtu ceku se në seancën e kaluar e kam shtruar pyetjen rreth punimeve të një objekti që po zhvillohen në rrugën "Agim Ramadani". Atij objekti për shumë vite i është ndaluar puna në mungesë të lejes dhe është thënë nga kryetari se puna është ndaluar për shkak të një mosmarrëveshjeje mes pronarëve të tokës dhe investitorëve, por kjo përgjigje nuk qëndron, se ai objekt as atëherë as tani nuk i plotëson kushtet e ndërtimit, vërehet qartë që nga mungesa e hapësirave gjelbëruese, mungesa e parkingut etj. Lidhur me këtë bëjë thirrje për korrektësi e drejtësi, të gjithë të barabartë para ligjit, sepse një punë e mirë që mund të bëhet në një pjesë të qytetit ku lirohen trotualet nga shitësit ambulantë, nuk duhet me shërbyer si mbulesë për punë të keqe që bëhet në pjesën tjetër të qytetit.

**Petrit Reçica** tha se po t'i referohemi diskutimit të kryetarit për të gjitha ato të arritura të mira gjatë kësaj periudhe kohore, konsideroj se ato nuk qëndrojnë. Jam i interesuar të dijë se çka është duke bërë Komuna e Prishtinës për "Heat Save", si dhe kam kërkuar qasje në dokumentin zyrtar se për çka e ka përkrahur Komuna e Prishtinës festivalin e gastronomisë. Nëse është përkrahur, kush e ka përkrahur, kush e ka marrë vendimin, dhe mundësisht me e ditur edhe datën?

**Feim Osmani** tha se ky raport me gjendjen reale ka dallime esenciale. Disa projekte të vitit 2021 kanë qenë të kontraktuara edhe të buxhetuara dhe një pjesë e tyre të bartura në vitin 2022, po ashtu të bartura edhe për buxhetin e vitin 2023, siç janë ndërtimi i urave në fshatin Barilevë, ndërtimi i shkollës në fshatin Vranidoll, projekte të kontraktuara e të papërfunduara. Gjithashtu, subvencionimi në fushën e bujqësisë nuk është i mjaftueshëm, kështu që kërkoj nga kryetari që të ketë më shumë strategji e veprime në këtë sektor.

**Triera Kasumi - Berisha** u shpreh se meqë ne po raportojmë për një periudhe gjashtëmujore, e cila është esenciale sa i përket buxhetit, pse në raport nuk e kemi asnjë të dhënë se sa është shpenzuar nga ky buxhet, duke pasur parasysh që Komuna e Prishtinës ka vite që çalon në realizimin e buxhetit të plotë. Po ashtu, kërkoi të dijë se pse nuk kemi asnjë raport për ndërmarrjet publike lokale, e që konsiderohen si pjesë e punës së Komunës së Prishtinës.

**Berna Saraçi** tha se shikuar në aspektin social, në këtë raport mendoj se nuk është aspak e këndshme, por edhe nuk është njerëzisht korrekte që nga ky raportim vërehet që nuk është trajtuar me prioritet çështja e personave me nevoja të veçanta. Nëse e lexojmë raportimin, vërehet që nuk ka politika të veçanta për personat me nevoja të veçanta, prandaj mendoj që duhet marrë më me seriozitet dhe të vendoset paralelisht si prioritet me punët tjera që keni realizuar.

**U konstatua se u përkrah Raporti i punës së Kryetarit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022.**

## **Pika e tretë**

### **Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2023.**

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës, për vitin 2023, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtoare e Drejtorisë.

*Grupet parlamentare të LVV-së, AAK-së AKR-së dhe NISMA-s, në shenjë pakënaqësie rreth propozimit për ndarjen e buxhetit dhe miratimin e tij e lëshuan mbledhjen.*

**Kryesuesi konstatoi se në mungesë të kuorumit mbledhja nuk mund të vazhdojë dhe ajo u ndërpre në orën 12:00.**

**Vazhdimi i mbledhjes së shtatë, mbajtur më 21.09.2022, prej orës 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Nora Kelmendi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Rashit Gashi (LVV), Mirsad Vitija (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Rita Zeqiri (LVV), Tria Kasumi-Berisha (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Granit Geci (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Taulant Maxharraj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), dhe Agim Kuleta (LB).

**Munguan:** Arianit Beqiri (LVV), Berat Lahu (LVV), Petrit Reçica (LVV), Liridon Selmani, (PDK) Endrit Gashi (AAK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Gëzim Mehmeti (AKR) dhe Endrit Zabërgja, (NISMA).

Para se të fillohej me vazhdimin e mbledhjes, kryesuesi konstatoi se të pranishëm në sallë ishin 26 anëtarë të Kuvendit, dhe propozoi që të vazhdohet me pikën e tretë të rendit të ditës.

**Donjeta Dragusha** theksoi se korniza afatmesme buxhetore dhe buxheti për një vit janë dokumentet më të rëndësishme të Komunës, dhe rrjedhimisht përgatitja e tyre është procesi kryesor që po definojnë kahen të cilën kryetari Rama po ia jep kryeqytetit. Për vitin 2023, Komuna e Prishtinës do ta ketë buxhetin 105.675.981 euro, prej të cilave 34.166.863 euro, planifikon t'i marrë nga të hyrat vetanake, krahasuar me vitin e kaluar ka planifikuar të ketë 4 milion më tepër të hyra.

Ndërtimi i rrugës "A", ndërtimi i Spitalit të qytetit, ndërtimi i shkollave dhe çerdheve të reja, ndërtimi i nënkalimit në rrugën "Agim Ramadani", platforma ndërlidhëse e lagjes "Arbëria" me "Pallatin e Rinisë", ndërtimi i objektit të zjarrfikëseve, zgjerimi dhe modernizimin i ndriçimit publik, si dhe ndërtimi i shumë rrugëve në pjesën urbane dhe rurale, do ta bëjmë Prishtinën më praktike dhe në funksion të secilit qytetar, andaj për realizimin e këtyre projekteve na premtion buxheti i vitit 2023. Po ashtu, një përqendrim i projekteve është edhe për zonat rurale, si në infrastrukturë, ndërtimin e shkollave etj. Si GP i LDK-së e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

**Leutrim Retkoceri** tha se ne si GP i PDK-së, e kemi analizuar buxhetin dhe kemi shikuar që është i ndërtuar në një formë dhe frymë tjetër nga ata që kanë qenë më herët, andaj uroj që të ndodhë edhe implementimi i tij ashtu qysh është i planifikuar. I përshëndes të gjitha kodet që janë në këtë buxhet, me dëshirën më të madhe që vitin e ardhshëm të ketë buxhet edhe më të madh, në mënyrë që të ketë realizim të projekteve edhe më të mëdha nga Komunën e Prishtinës. Ne do ta votojmë këtë buxhet, duket kërkuar që këtij buxheti t'i shtohet edhe projekti më i rëndësishëm kombëtarë i qytetit, që është ndërtimi shtatores së Adem Jasharit, në Prishtinë.

**Muhamet Selmani** theksoi se në këtë propozimvendim për miratimin e buxhetit për vitin 2023 shihet se te menaxhimi i mbeturinave dhe pastrimi i qytetit, është e njëjta shumë që është paraparë nga vitet e kaluara dhe vazhdon jo vetëm për vitin 2023, por vazhdon edhe në vitin 2024-2025, kështu që duke pasur parasysh premtimin që të jetë një Prishtinë e pastër dhe e gjelbëruar, mendoj se duhet të reflektojnë në këtë pikë dhe të shohim mundësinë e rritjes së buxhetit dhe të hyrave, të jemi sa më të përgatitur për të kryer këtë premtim.

Meqë jemi në krizë energjetike, nuk e vërejtja asnjë projekt që dikush e ka paraparë instalimin e paneleve solar së paku në objektet publike, prandaj propozoj që të nxirret si vendim që asnjë leje ndërtimore në Prishtinë për vitin 2023, që të mos lëshohet pa e pasur edhe planin solar, ashtu siç kanë bërë të gjitha shtetet e mëdha.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Përparim Rama, kryetar dhe Valbona Makolli, drejtore.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 26 vota për, u miratua Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2023.**

#### **Pika e katërt**

**Propozimvendimi lidhur me Kornizën afatmesme buxhetore për periudhën 2023-2025.**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtore.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, me 26 vota për u miratua Vendimi lidhur me Kornizën afatmesme buxhetore për periudhën 2023-2025.**

## **Pika e pestë**

**Informatë për raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021, dhe plani i zbatueshmërisë.**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Osman Bllaca, drejtor i Zyrës së auditimit.

**Ermal Osmani** tha se ne vazhdimisht e kemi ngritur zërin në Kuvend për shkeljet që janë bërë, si dhe iu kemi drejtuar edhe medieeve, rrjeteve sociale, ju kemi drejtuar edhe organeve të drejtësisë për rastet e cekura në raport. Sa i përket planit të veprimit nuk po hyjë në detaje, pasi data e përfundimit është 31 dhjetor, pra kemi ende kohë edhe 3 muaj që të merrmi me veprimet që do t'i merrni ju dhe pas 3 muajve besoj që do të reagojmë edhe për punët e juaja.

**Fiknete Bejta** theksoi se në mandatin e kaluar ne si asamblistë jemi njoftuar për raportin e auditimit dhe nuk është marrë asnjë masë për ndryshimin e tij dhe vetëm janë përsëritur të gjeturat. Me organizimin e Zyrës së auditorit të brendshëm, e që është funksionale, ka ndërtuar një plan veprimi për implementimi e rekomandimeve të Zyrës kombëtare të auditimit dhe besoj se do të eliminohen të gjitha shkeljet që janë gjetur nga Zyra e auditimit.

Vetë fakti që 19 rekomandime janë të zbatueshmërisë së buxhetit, implementimit të kontratave, shkeljeve në lidhjen e kontratave nga Zyra e prokurimit dhe rekrutimit, mendoj që ka qenë shqetësuese edhe në mandatet e kaluara, por nuk është marrë për bazë. Ky raport i auditimit, ka konstatuar se pasqyrat financiare prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale dhe janë ndërtuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik, ashtu siç e tha edhe zyrtari i auditimit të Komunës së Prishtinës. Shqetësuese janë të gjitha faktet që Zyra kombëtare e auditimit i merr për bazë dhe nxjerr këtë opinion të kualifikuar. Ne mendojmë që Zyra e auditorit të brendshëm do ta rrisë cilësinë e kontrollit të brendshëm dhe besojmë se raporti i ardhshëm do të jetë shumë më pozitiv për performancën financiare të Komunës së Prishtinës.

**Leutrim Retkoceri** tha se njëra nga të gjeturat që është e pakalueshme, është mos regjistrimi i pronave, mos dhënia e kontratave për shfrytëzuesit e banesave, dhe çështja tjetër që janë të punësuarit apo të angazhuarit, që në vitin e kaluar kishin qenë 168 punonjës të cilët nuk kanë aplikuar në procedura të rregullta të rekrutimit.

Uroj që këto çështje të adresohen saktë dhe të zgjidhen vitin e ardhshëm.

**Rashit Gashi** u shpreh se për mua shkelja më madhe është rreth rekrutimit, pra dhe nga përvoja që vij nga sindikata, edhe pse zyra e ka cilësuar si një shkelje të butë, duke e dhënë një rekomandim, duhet që në të ardhmen të kemi një fokus kryesor rreth procedurave të rekrutimit. Me gjithë këto shkelje nga viti paraprak, ku në vitin 2020, janë përcjellë gjatë fazave të auditimit për përmirësim, kanë qenë diku rreth 15 shkelje. Po ashtu, si do të jenë pasqyrat financiare të vitit 2022, kur kemi një auditor të brendshëm, i cili nuk i ka respektuar procedurat e rekrutimit gjatë kësaj faze, prandaj kryetar duhet të keni parasysh shumë që në të ardhmen të merreni me këtë rast. Nëse nuk janë ndjekur procedurat siç duhet, ky konkurs është dashtë të kthehet në pikën zero. Po ashtu, kërkoj të dijë se a ka plan të punës auditori i brendshëm, a mund të na e dërgoni atë plan të punës në ndërkohë.

Lidhur me vërejtjet dh sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Osman Bllaca.



U konstatua se u përkrah Informata për raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021, dhe plani i zbatueshmërisë.

Pika e gjashtë

## Raportimi i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Përparim Rama, kryetar.

**Nora Kelmendi** kërkoi të dijë se a ka ndonjë informatë se sa prona të lira ka Komuna për dhënie në shfrytëzim, pasi që në tabelën e përgjithshme nuk e dimë cilat prona janë të lira, cilat të uzurpuara dhe cilat prona janë të dhëna në shfrytëzim. Siç po shihet, shumica e këtyre pronave, disa që i dimë ne që jetojmë në Prishtinë, janë të uzurpuara, ju si kryetar a keni marr ndonjë vendim për shkëputje të këtyre kontratave me të cilin vendim ne duhet të njoftohemi si Kuvend komunal, dhe a keni përpiluar ndonjë planë dinamik për mbikëqyrjen e këtyre kontratave të pronave të dhëna në shfrytëzim.

Përkitazi me shqetësimet e ngritura nga znj. Kelmendi, sqarime shtesë dha Doruntinë Maloku, drejtoreshë.

**Dhurata Jahaj - Retkoceri** tha se në vitin 2014 Komuna kishte bërë verifikimin e të gjitha pronave komunale, në mesin e të cilave edhe ngastrat nëpër zonat industriale, të cilat shfrytëzohen nga të gjitha bizneset private pa asnjë kompensim ndaj Komunës, duke shkaktuar humbje financiare për buxhetin e Komunës. Tani pronat komunale shfrytëzohen vetëm përmes kontratave valide dhe marrjen e veprimeve konkrete në arkëtimin e të hyrave. Është bërë miratimi i listës së veçantë të pronave të paluajtshme komunale të cilat mund të jepen në shfrytëzim, është formuar grupi punues për verifikimin e statusit të pronave komunale, është themeluar komisioni për hartimin e Rregullores për dhënie me qira deri në 1 vit të pronave komunale, si dhe është themeluar Komisioni për shitjen e të drejtave banesore, pra të gjitha këto veprime kanë ndodhur në këta 6 muaj të qeverisjes së re komunale. Në emër të GP të LDK –së përshëndes dhe çmoj lart të gjitha këto veprime që po bëhen për të zbatuar Ligjin për shfrytëzimin e pronës komunale, si dhe për të liruar prona dhe hapësirat publike komunale.

**Leutrim Retkoceri** tha se edhe ne e përshëndesim këtë raport dhe e inkurajojmë kryetarin për këtë hap që e ka marrë në identifikimin e pronave komunale.

**Gëzim Sveçla** u shpreh se duke pasur parasysh formimin e disa komisioneve që do të merren me këtë çështje, kjo nënkupton që rezultatet të cilat do t'i prodhojnë këto komisione mund të vonohen. Lidhur me këtë shtoi se, duhet të kemi kujdes sepse mund të ndodh tek pronat të cilat janë në mirëbesim, e që llogariten prona të cilat kanë kontratë shfrytëzimi, mund të arrihet parashkrimi fitues dhe pastaj dalin telashe të tjera. Mendojmë se kjo punë mund të bëhet në mënyrë parciale, p.sh. si punë e parë dhe shenjë e vullnetit të mirë kishte me qenë nëse më shpejtë arrihet një produkt i këtyre komisioneve në lidhje me banesat në lagjen "Bregu i Diellit", të cilat siç dihet janë një pjesë e madhe e tyre të lëshuara për zyrtarët e LDK-së.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Përparim Rama, kryetar, dhe Doruntinë Maloku, drejtore.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raportimi i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale.**

**Pika e shtatë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të: Flora (Hasan) Çunajt, Arta (Nysret) Maliqit, Fatima (Hamit-Vej Nusret) Maliqit, Hana (Nysret) Maliqit, Arbëresha (Adem) Maliqit, Nevzat (Adem) Maliqit, Nexhat (Adem) Maliqit, Nakije (Nysret) Morinës, Nazan (Adem) Maliqit, Selamete (Hasan) Maliqit, Mevlyde (Hasan) Maliqit, Zana (Hasan) Sejdiut, Albulena (Hasan) Maliqit, Maliq (Abdul) Maliqit, Mihibe (Hasan) Makollit, Gëzim (Hasan) Maliqit dhe Luan (Nysret) Maliqit”.

Lidhur me propozimvendim për këmbimin e pronave të paluajtshme, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë Maloku, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 38 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të: Flora (Hasan) Çunajt, Arta (Nysret) Maliqit, Fatima (Hamit-Vej Nusret) Maliqit, Hana (Nysret) Maliqit, Arbëresha (Adem) Maliqit, Nevzat (Adem) Maliqit, Nexhat (Adem) Maliqit, Nakije (Nysret) Morinës, Nazan (Adem) Maliqit, Selamete (Hasan) Maliqit, Mevlyde (Hasan) Maliqit, Zana (Hasan) Sejdiut, Albulena (Hasan) Maliqit, Maliq (Abdul) Maliqit, Mihibe (Hasan) Makollit, Gëzim (Hasan) Maliqit dhe Luan (Nysret) Maliqit.

**Pika e tetë**

Projektregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Prishtinës, nr. 01-030/01-0134831/18, dt. 06.06.2018.

Përkritazi me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Bersant Beka, drejtor.

**Feim Osmani**, me diskutimin e tij kryesisht u përqendruar rreth vërejtjeve dhe kërkesave për ndryshim të kësaj projektregulloreje, duke thënë se nuk janë përfshirë ato kërkesa, e që konsiderojmë se janë edhe përmbajtjesore edhe tepër të nevojshme të inkorporohen në këtë projektregullore. Duke e pasur parasysh përvojën e gjatë në shërbim të bashkësive lokale, konstatojmë se kjo projektregullore për të qenë në funksion të zgjedhjes së këshillave të lagjeve dhe fshatrave, patjetër duhet të plotësohet dhe ndryshohet ne nenet 4.1, 4.2, 4.3, 5.13, 6.1 dhe në nenin 6.2.

Këto janë të gjitha vërejtjet që ne i kemi konstatuar edhe më herët dhe tash konsiderojmë se duhet t'i bashkëngjiten ose inkorporohen në rregullore, për të mos pasur problem pastaj në punën në teren dhe nëse merren në konsideratë këto propozime për ndryshime, jemi për miratimin e kësaj projektregulloreje.

**Milazim Vitija** tha se unë si kryetar i bashkësisë lokale, kam qenë edhe hartues i kësaj rregulloreje në vitin 2016, së bashku me drejtorin e Administratës dhe shefin e Sektorëve të bashkësive lokale, pavarësisht kësaj janë dy-tri gabime teknike që duhet të merren parasysh për ndryshim. Te fshati Mramur-Busi-Novosellë, duhet t'i shtohet edhe Zllashi dhe Suteska, që janë dy lagje. Fshati Novosellë pothuajse nuk ekziston, për arsye se liqeni i Badovcit e ka larguar prej aty dhe nuk është më si fshat, ndërsa Slivova dhe Kukavica e Dragovci e kanë edhe Llajshevcin edhe Mukatën. Te tabela e kilometrave katrorë te fshati Marvec është 78.8 kilometra katrorë, ndërsa duhet të jetë 112 kilometra katrorë. Me këto përmirësime jemi për miratimin e kësaj projektregulloreje.

**Leutrim Retkoceri** tha se në mungesë të plotësimit dhe ndryshimit të kësaj rregulloreje, nëpër fshatra nuk ka pasur riorganizim të këshillave të Bashkësisë lokale. Neni 4, pika 4.1 që ka të bëjë me numrin e anëtarëve të komisionit, mendoj se duhet të specifikohet, në mënyrë që rregullorja mos të ketë nevojë pastaj për marrëveshje apo një interpretim tjetër të radhës.

**Sami Boroci**, gjithashtu shprehu mendimin se neni 4, pika 4.1 duhet specifikuar edhe më shumë te pjesa e përfaqësimit të partive politike që kanë me qenë pjesë e atij komisioni. Nuk është korrekte me u përfaqësuar ky komision veç prej pozitës, por mendoj që duhet me u precizuar veç ky detaj.

**Feim Osmani** po ashtu, ceku se propozimet tona për plotësim-ndryshimin e kësaj rregulloreje mendoj se janë esenciale dhe i kontribuojnë pikërisht mbarëvajtjes së procesit zgjedhor. Nëse nuk inkorporohen propozimet tona në këtë projektregullore, mendoj që nuk është në rregull, nuk i kontribuon procesit të zgjedhjeve tutje.

**Hafiz Krasniqi** lidhur me këtë projektregullore, kërkoi të dijë se kur do të fillojë dinamika e veprimit dhe a do të kishte mundësi që këto komisione të formohen, në mënyrë që të fillojnë sa më shpejt me veprimin në terren.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësi, sqarime shtesë dha Bersant Beka, drejtor.

**Kryesuesi konstatoi se me propozimet e dhëna, njëzëri, më 37 vota për u miratua Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës, nr. 01-030/01-0134831/18, dt. 06.06.2018.**

## **Pika e nëntë**

### **Propozimvendimi për transferimin e mjeteve nga kategoria e subvencioneve të administratës në kategorinë e subvencioneve të Drejtorisë së Arsimit.**

Prezantimin e kësaj pike të rendit të ditës, në pika të shkurtra e paraqiti Valbona Makolli, drejtore.

**Gëzim Sveçla** tha se këtë çështje e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së, prandaj mbetet për t'u rregulluar edhe disa kriteret që kanë të bëjnë në përgjithësi me menaxhimin e këtyre çerdheve, për shkak se në njëfarë mënyre me informatat që i kemi gjithë barra, qoftë ajo financiare, qoftë ajo tjetër është e Komunës. Për shkak se kemi të bëjmë me pagat e atyre punonjësve që punojnë aty, ne këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

**Ajet Brajshori** theksoi se edhe ne si Grup parlamentar, këtë çështje e kemi diskutuar, e kemi bërë edhe një analizë të gjerë dhe jemi për transferimin e këtyre mjeteve që të ju ndihmojmë këtyre kopshteve. Ata fëmijë janë tanët, ato kopshte janë objekte të Komunës, ku rreth 300 mijë euro janë dhënë deri më tash dhe nuk është dhënë asnjë llogari për këtë. Tani është një adresë, do ta kemi një mbikëqyrje dhe në shpenzimin e këtyre mjeteve, dhe si GP jemi për miratimin e këtij propozimvendimi.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 35 vota për u miratua Vendimi për transferimin e mjeteve nga kategoria e subvencioneve të administratës në kategorinë e subvencioneve të Drejtorisë së Arsimit.**

## **Pika e dhjetë**

### **Propozimvendimi për financimin, pagesën e shujtës ditore për shërbyesit civilë të administratës të Komunës së Prishtinës.**

**Jeta Rafuna** tha se ashtu siç jemi në dijeni, ne të gjithë kemi marrë një kërkesë nga Sindikata e pavarur e punëtorëve të Komunës së Prishtinës, që t'i ndihmojmë me mjete financiare, pa si që punëtorët e Komunës së Prishtinës i kanë pagat më të ulëta dhe ju nevojitet ndihma jonë, sidomos në këtë kohë kur çmimet janë ngritur shumë në Kosovë, sidomos çmimet elementare.

**Valbona Makolli**, drejtore, tha se nëse kjo kërkesë aprovohet, ne si Drejtori e Financave këtë kërkesë ja drejtojmë Ministrisë së Financave dhe mbetet në mëshirën e tyre a e aprovojnë apo jo.

**Gëzim Sveçla** tha se për këtë kërkesë është dashtë të paktën të jepen edhe disa sqarime se përderisa ne duam që të votojmë diçka, duhet ta dimë se a përfshihen të gjithë punëtorët të cilët janë në Komunë dhe sa është shuma e mjeteve financiare.

**Leutrim Retkoceri** u shpreh se ne si GP do ta mbështesim këtë, duke pasur parasysh situatën, rritjen e çmimeve, krizën ekonomike, dhe të gjitha këto janë më se të arsyeshme që kjo çështje të procedohet më tutje.

**Sami Boroci** tha se kjo kërkesë është shumë e paqartë dhe nuk e di nëse arrijmë kështu ta realizojmë tamam kërkesën e tyre. Vlera e kërkuar prej 5 euro duhet të zvogëlohet, të jetë në 3 euro, pra të gjendet një zgjidhje që kjo të realizohet dhe të mbërrijë tek punëtorët e Komunës, sepse në këto rrethana mendoj që ne duhet t'i ndihmojmë dhe duhet t'i mbështesim.

**Feim Osmani** tha se krahas ndihmës për shërbyesit civilë në Komunë, është një shtresë shumë e diskriminuar, të cilët janë punëtor të mirëmbajtjes dhe të sigurimit, të cilët çfarëdo ndihme që e plotëson kriterin ligjor nuk mendoj se duhet të ndahen dhe jam që në të njëjtën pako të hyjnë të gjithë.

**Fiknete Bejta** tha se edhe ne si GP e kemi analizuar këtë kërkesë dhe nuk jemi që me e pasur vetëm një muaj një pako dhe me u ndalur kjo pagesë, kjo të jetë sistematike dhe e vazhdueshme. Koston e kemi llogaritur, nuk është e papërballueshme për Komunën, vetëm është pikëpyetje prej kategorisë buxhetore. Jemi të vetëdijshëm që përmes kategorisë "paga dhe mëditje" nuk është e mundur, sepse ligji nuk e lejon një pagesë të tillë, mirëpo Komuna dhe Drejtoria e Financave nëse e analizon më mirë këtë situatë mundet me gjetur një zgjidhje.

**Triera Kasumi - Berisha** tha se të gjitha propozimet dhe vendimet të jenë në konsultim dhe koordinim me Zyrën ligjore, që të mos kemi përgjigje negative prej Qeverisë në emër të asaj që Qeveria nuk po aprovon pa bazë, ose po kthen vendime, qysh është kthyer rasti i Vendimit për lokacionin e strehimores të qenve endacakë.

**Milazim Vitija** propozoi që shuma e mjeteve financiare për shujtën ditore të punëtorëve të Komunës të jetë prej 3.5 euro, pra të gjendet forma e mjeteve monetare për kompensim.

**Ermal Osmani** kërkoi të dijë se çfarë kapaciteti kemi te Kuzhina popullore, e cila është në kuadër të Komunës së Prishtinës, a ka kapacitet, a mundemi me shfrytëzuar kuzhinën popullore për shujta, nëse po, atëherë me gjetur edhe këtë mënyrë.

**Hafiz Krasniqi** tha se të gjitha grupet parlamentare u pajtuan që të përkrahet kërkesa e Sindikatës, nuk mundemi ne tash të mendojmë se çfarë vendos Ministria e Financave. Obligimi ynë moral dhe profesional është që ta marrim vendimin, në mënyrë që t'i hapim rrugë kësaj kërkesë dhe propozoj të qitet në votim.

**Elmire Nikqi - Rexha** tha se në rast se Sindikata brenda Komunës na dërgon në gjykatë dhe fitohet rasti prej tyre, Komuna a ka për obligim me i kompensuar ato shujta dhe nga vijne ato mjete për pagesë.

Lidhur me vërejtët dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Valbona Makolli, Arben Kçira dhe Osman Bllaca.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 26 vota për, u miratua Vendimi për financimin, pagesën e shujtës ditore për shërbyesit civilë të Administratës së Komunës së Prishtinës.

*Mbledhja përfundoi në orën 15:45.*

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit  
Fehmi Kurteshi



Faqe 13 nga 13